

Si të merrni këtë shërbim

Për të gjetur farmacinë më të afërt që ofron këtë shërbim, skanoni kodin QR ose [mësoni më shumë këtu](#).



Ju lutemi të sillni një dokument identifikimi dhe dëshmi të përshtatshmërisë nga kriteret e listuara në këtë fletëudhëzues.

Nëse nuk jeni të sigurtë, personeli i farmacisë tuaj do të jetë në gjendje t'ju ndihmojë.



A keni nevojë për ndihmë ose këshilla mjekësore?



Farmacia

Personeli i farmacisë tuaj mund të ofrojë këshilla dhe trajtim ekspertësh pa recetë ose pa nevojë për një takim.

Takimet me GP në mbrëmje dhe fundjavë

Kërkoni online për qendrat e GP në lagjen tuaj.

NHS 111

Nëse keni nevojë për ndihmë urgjente mjekësore, telefononi 111 ose vizitoni 111 në internet. Është falas dhe i hapur 24/7.

Shëndeti mendor

Nëse ju duhet ndihmë urgjente telefononi **111** ose vizitoni **111 në internet** dhe zgjidhni opsionin e shëndetit mendor.

NHS.uk

Vizitoni www.nhs.uk për informacione që kuptohen lehtë mbi një sërë problemesh shëndetësore.

Dentisti

Nëse keni nevojë për kujdes dentar urgjent, telefononi **111** ose vizitoni **111 në internet**.

Telefononi 999

Nëse ka një emergjencë kërcënuese për jetën, si një aksident i rëndë rrugor, goditje në tru ose sulm në zemër.

Çfarë ndodh nëse nuk flas anglisht?



Disa farmaci kanë në dispozicion shërbime përkthimi.

I tregoni farmacisë se cilën gjuhë flisni dhe ata mund të jenë në gjendje t'ju ndihmojnë.

NHS

Barna falas për shqetësimet e zakonshme

A kualifikoheni për ilaçe falas nga farmacia juaj lokale?



Nëse keni të ardhura të ulëta, mund të merrni ilaçe falas për disa probleme të zakonshme shëndetësore nga një farmaci pjesëmarrëse.



Skema e barnave falas (ose Skema e Barnave të Vetë-Kujdesit) ndihmon njerëzit të menaxhojnë problemet e zakonshme shëndetësore përmes farmacisë së tyre lokale dhe të shmangin vizitën te mjeku i përgjithshëm GP.

Merrni ilaçe falas për shqetësime të tilla si:

- Këmba e atletit
- Dhimbje shpine
- Kapslëku (mosha mbi 12 vjeç)
- Dermatiti i kontaktit
- Diarrea
- Mostretja (dispepsia)
- Dhimbje veshi
- Ethe/dhimbje koke
- Hemorroide
- Ethet e sanës dhe alergjitë
- Morrat e kokës
- Lëndime të vogla
- Skuqje nga pampers
- Qere
- Zgjebja
- Dalja e dhëmbëve
- Krimbat e zorrëve
- Kandidoza vaginale
- Lythat dhe verrukat

Në disa raste, ky shërbim mund të kufizohet në tre konsultime për një periudhë tre mujore.

Kush mund të marrë ilaçe falas?

Ju mund të jeni në gjendje të merrni ilaçe falas nëse jetoni në Barnet, Camden, Enfield, Haringey ose Islington, keni të ardhura të ulëta dhe jeni në një nga grupet e mëposhtme:

- ✓ Personat në Universal Credit që kualifikohen për receta falas
- ✓ Personat me përfitime që i bëjnë ata të kualifikohen për receta falas, të tilla si:
 - ✓ NHS Skema e të Ardhurave të Ulëta me një certifikatë të vlefshme HC2
 - ✓ Personat që marrin Income Support ose Employment and Support Allowance
 - ✓ Job Seeker's Allowance e bazuar në të ardhurat
 - ✓ Certifikatë për përjashtimin nga Tax Credit
 - ✓ Pension Credit (Guarantee Credit)
- ✓ Personat që janë të pastrehë, me një letër për të pastrehët nga autoriteti lokal
- ✓ Të rinjtë e moshës 16-18 vjeç në arsim me kohë të plotë, arsim me kohë të pjesshme ose një stazh të akredituar
- ✓ Fëmijët nën 16 vjeç me një prind që kualifikohet për shërbimin

! **Kini parasysh se përjashtimi nga pagesat e recetës nuk ju kualifikon automatikisht për këtë skemë, përveç rasteve kur një nga kategoritë e mësipërme vlen edhe për ju.**